

VENDIM

Nr. 680, datë 2.9.2020

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të neneve 6 e 18/3, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, si person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Drejtësisë (këtu në vijim "ministri"), me seli në Tiranë.
2. Instituti i Mjekësisë Ligjore financohet nga buxheti i shtetit, tarifat dhe të ardhurat e tjera që krijohen nga kryerja e veprimtarisë së tij, burime të tjera të lejuara e të njohura nga legjislacioni në fuqi, si donacione vendëse dhe të huaja, si dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme. Instituti i Mjekësisë Ligjore ka buxhetin e vet, si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.
3. Misioni i Institutit të Mjekësisë Ligjore është të mbështesë organet e drejtësisë, si dhe institucionet e tjera publike për zgjidhjen e çështjeve hetimore dhe gjyqësore, me karakter mjekësor e biologjik, në veprimtarinë kriminale dhe konfliktet civile, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve që përfshihen në funksionet administrative që i janë deleguar nëpërmjet këtij vendimi.
4. Instituti i Mjekësisë Ligjore e ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit, në këto fusha përgjegjësie:
 - a) ekspertimin mjekoligjor, toksikologoligjor, biologjikoligjor dhe psikiatroligjor, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi;
 - b) sigurimin e cilësisë së shërbimit të ekspertimit të përmendur në shkronjën "a", të kësaj pike;

c) kualifikimin e vazhdueshëm të ekspertëve mjekoligjorë, toksikologoligjorë, biologoligjorë, antropologoligjorë, si dhe të nëpunësve të tjerë e specialistëve, veprimtaria e të cilëve lidhet me këto fusha.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE

5. Instituti i Mjekësisë Ligjore ka përgjegjësi të organizojë:

a) punën për kryerjen e ekspertimeve mjekoligjore, toksikologoligjore, biologjikoligjore dhe psikiatroligjore;

b) punën për kryerjen e veprimtarive kërkimore shkencore në fushën e mjekësisë ligjore;

c) punën për sigurimin e kualifikimit të vazhdueshëm të ekspertëve mjekoligjorë, toksikologoligjorë, biologoligjorë, antropologoligjorë, si dhe të nëpunësve të tjerë e specialistëve, veprimtaria e të cilëve lidhet me këto fusha;

ç) dhe të drejtojë veprimtarinë e shërbimeve të ekspertimit mjekoligjor në Republikën e Shqipërisë.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE

6. Instituti i Mjekësisë Ligjore e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai organizohet në nivel qendror dhe cakton përfaqësues për ushtrimin e funksioneve pranë çdo gjykate apeli.

7. Instituti i Mjekësisë Ligjore drejtohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e institucionit dhe përgjigjet përpara ministrit.

8. Instituti i Mjekësisë Ligjore kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) kryen ekspertime mjekoligjore, toksikologoligjore, biologjikoligjore dhe psikiatroligjore, si dhe veprime të tjera, sipas rasteve dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale dhe në ligje të tjera të posaçme;

b) kryen veprimtari kërkimore-shkencore për zbulimin dhe zbatimin e metodave bashkëkohore në fushën e mjekësisë ligjore;

c) përgatit dhe realizon kualifikimin e vazhdueshëm të ekspertëve mjekoligjorë, toksikologoligjorë, biologoligjorë, antropologoligjorë, si dhe të nëpunësve të tjerë apo specialistëve, veprimtaria e të cilëve lidhet me këto fusha.

9. Instituti i Mjekësisë Ligjore kryen ekspertime sipas kërkesës ose vendimit të oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit ose gjyqtarit si dhe Avokatit të Popullit, për çështjet që shqyrtohen prej tyre sipas legjislacionit në fuqi. Instituti i Mjekësisë Ligjore, sipas ligjit, kryen ekspertime mjekoligjore edhe me kërkesën e palëve në procesin civil, të subjekteve të

procedimit penal dhe të personave të tjerë juridikë publikë, kundrejt pagesës së shpenzimeve dhe të tarifave përkatëse, sipas përcaktimit të pikës 10, të këtij vendimi.

10. Ekspertimi që kryhet me kërkesë të palëve në një proces civil, të subjekteve të procedimit penal, të ndryshëm nga gjykata, prokurori ose Policia Gjyqësore, si dhe të personave të tjerë juridikë publikë kryhet kundrejt pagesës së tarifave. Lloji dhe masa e tarifës për çdo veprim që kryhet nga Instituti i Mjekësisë Ligjore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit që mbulon çështjet e drejtësisë dhe ministrit që mbulon çështjet e financave.

11. Instituti i Mjekësisë Ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit dhe të përgjegjësisë së tij, bashkërendon veprimtarinë, me:

a) institucionet shëndetësore për parandalimin e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e pacientëve;

b) institucionet homologe ndërkombëtare;

c) institucione të tjera të administratës publike.

12. Struktura dhe organika e Institutit të Mjekësisë Ligjore miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

13. Rregullat për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri, me propozim të drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

14. Marrëdhëniet e punës të drejtorit dhe të nëpunësve të Institutit të Mjekësisë Ligjore rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civilë. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

15. Marrëdhëniet ndërmjet Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe institucioneve të tjera të administratës publike rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe titullarit përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Marrëdhëniet e Institutit të Mjekësisë Ligjore me Policinë Gjyqësore, gjykatën dhe personat rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Procedurës Civile, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

17. Instituti i Mjekësisë Ligjore ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet: "Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Mjekësisë Ligjore", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

18. Vula e Institutit të Mjekësisë Ligjore ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes

së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

19. Vendimi nr. 120, datë 27.2.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore", shfuqizohet.

20. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe